722. Fondi Nr.4, Dosje nr.7, me 4 (katër) fletë, viti 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
723. Fondi Nr.4, Dosje nr.91, me 13 (trembëdhjetë) fletë, viti 1982. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
724. Fondi Nr.4, Dosje nr.32, me 11 (njëmbëdhjetë) fletë, viti 1988. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
725. Fondi Nr.4, Dosje nr.18, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, viti 1985. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
726. Fondi Nr.4, Dosje nr.52, me 3 (tre) fletë, viti 1957. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
727. Fondi Nr.4, Dosje nr.99, me 12 (dymbëdhjetë) fletë, viti 1974. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
728. Fondi Nr.4, Dosje nr.106, me 14 (katërmëdhjetë) fletë, viti 1969. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
729. Fondi Nr.4, Dosje nr.107, me 10 (dhjetë) fletë, viti 1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
730. Fondi Nr.4, Dosje nr.68, me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë, viti 1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
731. Fondi Nr.4, Dosje nr.103, me 30 (tridhjetë) fletë, viti 1981. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
732. Fondi Nr.4, Dosje nr.251, me 34 (tridhjetë e katër) fletë, viti 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
733. Fondi Nr.4, Dosje nr.252, me 41 (dyzet e një) fletë, viti 1987. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
734. Fondi Nr.4, Dosje nr.85, me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë, viti 1949. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
735. Fondi Nr.4, Dosje nr.35, me 58 (pesëdhjetë e tetë) fletë, viti 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
736. Fondi Nr.4, Dosje nr.34, me 25 (njëzet e pesë) fletë, viti 1946. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
737. Fondi Nr.4, Dosje nr.64, me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
738. Fondi Nr.4, Dosje nr.356, me 38 (tridhjetë e tetë) fletë, viti 1964. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
739. Fondi Nr.4, Dosje nr.258, me 31 (tridhjetë e një) fletë, viti 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".
740. Fondi Nr.6, Dosje nr.680, me 41 (dyzet e një) fletë, viti 1960. Niveli i klasifikimit të dosjes është "Tepër Sekret".

741. Fondi Nr.4, Dosje nr.91, me 7 (shtatë) fletë, viti 1977. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.
742. Fondi Nr.4, Dosje nr.44, me 9 (nëntë) fletë, viti 1958. Niveli i klasifikimit të dosjes është “Tepër Sekret”.

KRYETARI I KDZH-së
Dr. Gentiana Sula



KUJTESA

**DHE EDUKIMI
QYTETAR**

PËRKUJTOJMË POETËT MËSUES VILSON BLOSHMI DHE GENC LEKA, PËRMES KRIJIMTARISË SË TYRE LETRARE SJELLË NË BOTIMIN ME TITULL: "KUR BOTA ISH NË GJUMË"

Tiranë, 2 mars 2023 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit në



bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, me nismën e familjarëve, përkujtoi poetët mësues Vilson Blloshmi dhe Genc Leka, të nderuar me titujt "Mësues i Popullit", "Nderi i Kombit", "Martir i demokracisë".

Poetët u risollën përmes krijimtarisë së tyre letrare, publikuar në librin "Kur bota ish në gjumë", nga botuesi Bardhyl Musai, ku çdo poezi shoqërohet me komente që e shtyjnë lexuesin, të perceptojë poetikisht tekstin.

Gjatë aktivitetit u mbajtën fjalët e organizatorëve dhe përfaqësuesve të institucioneve, në praninë e familjarëve të poetëve, përfaqësuesve të shoqatave, të universiteteve të vendit, studiuesve, kërkuesve shkencorë, institucioneve publike dhe joqeveritare, si dhe nxënësve nga shkolla të mesme në vend.



Fjalën e hapjes e mbajti Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, e cila, ndër të tjera, tha se: "Nuk ka moment më të thellë tragjik, sesa ky i këtyre dy poetëve që u përcaktuan nga regjimi si shënjestra, pikërisht për të "vërtetën e kithët, por të plotë". Me falënderime për bijat, që e sollën këtë vepër të nevojshme, me një skemë të dobishme kuptimi, botuesin prof. Bardhyl Musai, studiuesin Dr. Eris Rusi dhe profesoreshën, znj. Sula theksoi, se: "Libri do të përfshihet në platformën mbi edukimin e AIDSSH në bashkëpunim me Ministrinë e

Arsimit dhe Sportit, duke shërbyer si instrument i njohjes së diktaturës, që nuk kishte kufij në ndëshkim, kur tentohej dalja prej saj, si në rastin e dy poetëve".

Në fjalën e tij, Presidenti i Republikës, Sh.T. Z. Bajram Begaj, u drejtoi një mesazh të rinjve: "Të rinjtë tanë, veçanërisht ata që kanë lindur në periudhën e demokracisë, duhet të mësojnë për këtë pjesë të hidhur të historisë sonë, ku mijëra u vranë, u torturuan, u burgosën, u internuan dhe u persekutuan vetëm se mendonin ndryshe nga regjimi. Sepse, ata besonin te të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Bashkorganizatore në aktivitet dhe në projektin dypalësh mes institucioneve, Ministrja Kushi, pasi



përkujtoi me nderim dy poetët mësues, përgëzoi botuesin dhe bashkëpunëtorët e këtij botimi, duke e parë si vlerë të shtuar për platformën digjitale "Burime mësimore të hapura 1944-1991", ndërmarrë nga Autoriteti, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

Prof. Musai, si botues dhe studiues foli për veçoritë e botimit të këtij libri, si dhe krijimtarinë letrare të Vilson Blloshmit dhe Genc Lekës.

Simon Mirakaj, ish-anëtar i Autoritetit, rrëfeu për të rinjtë e pranishëm, fakte nga jeta e vështirë në kampet komuniste, ku të internuarit, mes tyre dhe vetë, kaluan një jetë pa liri, me vështirësi ekstreme

ekonomike dhe nën presionin e operativëve të Sigurimit të Shtetit, si dhe pushtetarëve lokalë komunistë.

Mes emocioneve, Enerjeta Blloshmi, vajza e Vilson Blloshmit, ndau me të pranishmit përjetimet e së shkuarës, kalvarin e vështirësive, si pasojë kësaj të shkuare.



Prof. Lili Sula dhe Dr. Eris Rusi analizuan tekstin e botimit, nga pikëpamja e kritikës letrare dhe vlerësuan maksimalisht, punën e bërë me librin.

Në mbyllje, nxënës të pranishëm recituan, nën tingujt e violinës, disa nga poezitë e Blloshmit dhe Lekës.

Vilsoni Blloshmi lindi në Bërzeshtë, të rrethit të Librazhdit. Pas përfundimit të shkollës, kthehet në fshatin e lindjes, ku do të merrej me bujqësi dhe punë në minierë. Pasioni e shtynte të përkthente dhe shkruante poezi, por shtypi dhe shtëpitë botuese të kohës ia mbyllnin dyert, për "biografi të keqe". Regjimi i kish vënë damkën e kulakut.

Katër muaj para se ta burgosnin, letërkëmbimi, ditarët, poezitë dhe përkthimet e Vilson Blloshmit u sekuestruan nga policia. Shteti, që e kishte ndaluar të merrej me letërsi, papritur po interesohej posaçërisht, për këtë krijimtari letrare, të shkruar në fshehtësi dhe të kësaj nëpër sëndukë.

Genc Leka, po ashtu lindi në Bërzeshtë. Që në bankat e shkollës, e përdoqën spiunët dhe agentët e shërbimit të Sigurimit. Netëve, kur nuk e zinte gjumi, mblidhej në aneksin ku ishte dhe një sënduk me libra, dhe përkulej mbi shkrimet e tij. Lexonte dhe dëgjonte Moxartin, Shubertin. Proza lirike e Paustovskit me personazhet e tij, me tipa pak rebelë, të lënë mënjanë nga shoqëria, i pëlqenin. Në letra të stolitura poezish, hidhte mendimet në të cilat jo rrallë, i kalonte edhe mendimi i vdekjes. I afërt e i largët, njëkohshëm, për poetin.



Poetët u arrestuan në fund të gushtit 1976 dhe u pushkatuan në korrik të vitit 1977, me një akuzë të stisur e të rreme: Sabotim në ekonominë bujqësore të fshatit, agjitacion e propagandë.

Pas vitit 1991 u provua me dokumente, se Vilson Blloshmi dhe Genc Leka, nuk kishin kryer asnjë krim, sabotim a propagandë, andaj u shpallën zyrtarisht martirë.

Aktiviteti u zhvillua në funksion të pasurimit me burime arsimore, për Plaformën e Edukimit të Autoritetit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.

VIZITË E NJË PËRFAQËSIE NGA AMBASADA SUEDEZE NË TIRANË, ME RASTIN E FINALIZIMIT ME SUKSES TË PROJEKTIT TË MBËSHTETUR NGA QEVERIA SUEDEZE, PËR RIKONSTRUKSIONIN E GODINËS SË AUTORITETIT DHE KRIJIMIN E NJË ARKIVE



Tiranë, 3 mars 2023 - Autoriteti dhe Ambasada Suedeze organizuan ditën e sotme, një takim miqësor, në përmbyllje të projektit të mbështetur nga Qeveria Suedeze, sipas marrëveshjes së grantit me Autoritetin, për infrastrukturë bashkohore dhe kushte moderne, në ofrimin e shërbimeve qytetarëve dhe studiuesve.



Kryetarja e Autoritetit, znj. Gentiana Sula, shprehu falënderimin për bashkëpunimin, duke bërë një paraqitje të plotë të sfidave me projektin, si dhe atyre që Autoriteti synon të përmbushë, gjatë 5-vjeçarit të dytë.



Takimin e përshëndeti edhe Ambasadorja Elsa Hastad, e cila, e vuri theksin mbi disponibilitetin e treguar nga të dyja institucionet, për finalizimin me sukses, të këtij projekti, si dhe në misionin e përmbushur, për të ndihmuar kështu në zbardhjen e të kaluarës së Shqipërisë, me shtysën për Drejtësinë Tranzitore në vend.

Takimi u mbyll me një vizitë në arkivën e Autoritetit, si dhe të tjera ambiente.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula ligjëratë në Universitetin Europian të Tiranës:

Me kumtesën me titull: *“Qasja në dokumente sekrete, si mjet i pazëvendësueshëm në konsolidimin e demokracisë”*

Tiranë, 29 mars 2023 - Kryetarja e Autoritetit për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, mbajti më datë 29.03.2023, në Universitetin e Europian të Tiranës, ligjëratën me temë: *Qasja në dokumente sekrete, si mjet i pazëvendësueshëm në konsolidimin e demokracisë*.

E ftuar në kuadër të sesioneve akademike që zhvillon Fakulteti i Shkencave Juridike, Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në UET, kryetarja e Autoritetit, u shpreh se:

“Qasja në arkivat sekrete, të 47 viteve të ekzistencës së shtetit shqiptar, në fakt, është peshë e rëndë, por është dhe pikë kyçe e transformimit tonë, drejt demokracisë perëndimore.

Gjatë prezantimit, Znj. Sula trajtoi disa çështje kryesore që janë thelbësore në trajtimin e dokumenteve sekrete, si:

Dokumentet sekrete, interesi kombëtar dhe rënia e mitit të Sigurimit të Shtetit. Pse duhen hapur dokumentet sekrete? Çfarë është një i tillë? Pse i deklasifikojmë dokumentet?



Për të shkuar më tej, mbi rëndësinë e arkivit të mizorive dhe rolin në procesin e kujtesës dhe në drejtësinë tranzicionale. Çfarë e dallon atë, nga një arkiv normal dhe pasurimi me arkivat e gjalla (dëshmitë gojore). Arkivi, si mjet për drejtësi dhe dinjitet.

Po në këtë ligjëratë, Dr. Sula përshkroi për studentët dhe akademikët e UET, sesi ka evoluar institucionit të Autoritetit. Si u rrit, ndër vite? Stafi dhe ndryshimet ligjore; Kritikat dhe qasja ndaj tyre, krahas sfidave që e presin.

“E kam konsideruar mandatin e parë të punës, si një gur themeli për proceset tona të punës edhe pse ato janë shumë të gjata dhe puna me kujtesën, do të vijojë në dekada. Por, Autoriteti, për herë të parë theu tabutë: prekëm dosje të klasifikuara sekrete, i hapëm ato, gjë që nuk kishte ndodhur përpara. SHISH mbante një pjesë të konsiderueshme të tyre, një pjesë rrinin në Ministrinë e Brendshme të paprekshme. Ndërkohë që ishin mbushur plot 25 vjet, nga vendosja e pluralizimit në vend dhe në një vend demokratik, hapja e dokumenteve sekrete, nuk është më një tabu, ato kanë mjete, mekanizma dhe procese përmes të cilave, kryhet procesi i deklasifikimit të dokumenteve.”- tha kryetarja në fjalën e saj, duke theksuar rëndësinë e hapjes së dosjeve të policisë sekrete në komunizëm, si thelbësore për promovimin e mirëkuptimit historik, llogaridhënies, drejtësisë për viktimat dhe transparencës në qeveri, si e tillë që ndihmon në parandalimin e përsëritjes së regjimeve autoritare, duke promovuar një shoqëri më të hapur dhe demokratike.

Heqja e statusit “sekret”, solli edhe rënien e mitit se, policia sekrete në komunizëm, ishte e nevojshme për të ruajtur rendin. Ky është një argument i zakonshëm, që përdoret për të justifikuar ekzistencën e policisë sekrete në regjimet komuniste. Megjithatë, e vërteta është se policia sekrete përdorej kryesisht, për të shtypur disidencën dhe për të ruajtur pushtetin e partisë në pushtet.

Me hapjen publike të shumë dosjeve, për konferenca shkencore, por edhe studime të bëra për figura shumë të nderuara të kohës, me një aktivitet politik dhe shoqëror për t'u konsideruar një vlerë



kombëtare, si ajo e Martin Camajt, Arshi Pipës, Ernest Koliqit, Musine Kokalarit, Sabiha Kasimatit, etj., rrëzohet miti se, policia sekrete kishte në shënjestër vetëm armiqtë e shtetit.

Dokumentet na tregojnë për shënjestrimin nga ana policisë sekrete, të qytetarëve të thjeshtë, për shkelje të parëndësishme, si humori, barcoletat, anekdotat ose komentet kritike për qeverinë.

“Kur bëhet fjalë për dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, nuk bëhet më fjalë për një sekret, por për heqjen e një perdeje dhe zbulimin e identitetit të vërtetë, të vlerave. Gjërat e pathëna, gjërat e panjohura, për figura të ndritura të kësaj shoqërie, që i bëjnë mirë këtij kombi e kësaj shoqërie. Kjo gjë, bëhet për Shqipërinë dhe shqiptarët. Bëhet për fatet personale, që sot, secili të mos i lërë trashëgimi, të kaluarën e errët, fëmijëve.”- theksoi znj. Sula.

Më tej, gjatë prezantimit u ndal në çështjen e arkivit të dokumenteve që administrojnë Autoriteti, që është pasuruar me dëshmi gojore, rrëfime të ish-të përndjekurve politikë. Po ashtu, është pasuruar me analizat mbi dokumente, nga ana e historianëve, që nxjerrin në dritë shkeljet në proceset ligjore, shkeljen e të drejtave njerëzore, duke përfshirë punën e detyruar, torturën dhe vrasjet pa gjyq, zhdukjet e trupave të të pushkatuarve dhe të të ekzekutuarve me varje.

Ky arkiv, që në gjuhën akademike quhet “arkivi i mizorive”, është një mjet me bazë praktike për t'u përballuar me të shkuarën, për të formuar dhe transmetuar kujtesën, për të nxitur llogaridhënien dhe deklaruar të vërtetat e mohuara prej dekadash.

Në këtë mënyrë, arkivin, Autoriteti e ka përdorur si një kujtim simbolik i padrejtësive të së shkuarës, kjo duke vijuar dialogun e nisur 7 vite më parë, për veprimtarinë e policisë sekrete përmes dokumenteve të punës së krijuara nga vetë Sigurimi, si një burim njohjeje për individët dhe të afërmit e tyre të dënuar e përndjekur, vrarë, të zhdukur gjatë komunizmit, si burim provash, p.sh. për gjykime,



komisione të së vërtetës, verifikimit të zyrtarëve ose dëmshpërblimit të ish-të dënuarve, si mjet edukimi rreth padrejtësive të së kaluarës, duke plotësuar nevojën për respekt, për viktimat dhe si bazë për mospërsëritje në ekspozita, që janë bërë të aksesueshme për një publik më të gjerë dhe kanë impakt në shoqëri. Në këtë drejtim, Autoriteti po e përdor arkivin, si një mjet për ndërtimin e një platforme edukuese, për mësimet historike dhe jo vetëm, për mësuesit dhe nxënësit e sistemit parauniversitar.

Dr. Gentiana Sula: “Përvoja e re që kemi krijuar në drejtim të kujtesës dhe përdorimi i arkivave në funksion të saj, na ka treguar se është nevoja për më shumë ndërveprim dhe akses nëpër dokumente, sepse kjo e ndihmon shoqërinë tonë, të fitojë një kuptim më të plotë, të mizorive dhe t'u japë viktimave, një rehabilitim të merituar e të shumëpritur, si nga pikëpamja historike, psikologjike, ashtu edhe financiare.”

Në pjesën e tretë të prezantimit, kryetarja e Autoritetit foli për evoluimin e institucionit, krijimin e një arkivi të unifikuar, zgjerimin e stafit ndër vite, si dhe ndryshimet e duhura ligjore, që kanë ndikuar në rritjen e transparencës së plotë dhe objektive mbi dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit, në përputhje

me qëllimin dhe parimet e ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit, për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në përfundim, kryetarja theksoi se është e vendosur, për të mos e lënë të shkuarën në harresë dhe do të vijojë nismat, projektet komplekse, bashkëpunimin me individët dhe komunitetet, për ta profilizuar gjithnjë e më shumë, Autoritetin, si një platformë shërbimesh për qytetarët dhe studiuesit, duke synuar ridimensionim e figurave dhe ngjarjeve historike, dëshmitë gojore, qartësimin e fatit të zhdukurve në diktaturë; verifikimin e figurave publike, që ndikojnë drejtpërdrejt në kuadrin e reformës në drejtësi dhe rritjen e besimit në institucionet demokratike, si dhe realizimin e konferencave ndërkombëtare, që trajtojnë tema të së shkuarës sonë të afërt, me profesionalizëm dhe besim në vlerat njerëzore.

ASAMBLEJA PARLAMENTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS (APKE) MBËSHTET AUTORITETIN NË VEPRIMTARINË E ZBARDHJES SË TË SHKUARËS KOMUNISTE

Tiranë, 31 mars 2023 - U mbajt në Kuvendin e Shqipërisë seminari “Aksesi në Dokumentet Historike”



Një delegacion nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE), vizitoi Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, menjëherë pas përfundimit të seminarit me temë “Qasja në dokumentet historike” mbajtur sot në Tiranë, në Kuvendin e Shqipërisë.

Delegacioni nga APKE u shoqërua nga kryetarja dhe anëtarët e Autoritetit, të cilët, i njohën me punën e institucionit, sfidat e tashme dhe të ardhme, si dhe me hapësirat e reja ku zhvillon veprimtarinë Autoriteti.

Znj. Gentiana Sula, kryetare e Autoritetit i njohu përfaqësuesit e Asamblesë Parlamentare me punën e bërë që në themelimin e institucionit, kur vendimi i parë ishte caktimi i ndërtesës së Autoritetit. Për vite me radhë, u punua për rikonstrukcionin sipas standardeve bashkohore, të ruajtjes dhe sigurisë.

Të pranishmit vizituan arkivin e dokumenteve të Sigurimit dhe u informuan për proceset e punës, mënyrën e ruajtjes, tipologjinë e dosjeve, etj.

Drejtuesja i këtij delegacioni, znj. Louise Barton, Drejtore e Dinjitetit Njerëzor dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, deklaroi mbështetjen për punën e Autoritetit, sidomos në drejtimin e deklasifikimit të dokumenteve, si dhe rëndësinë që paraqet e transparenca e autoriteteve publike në një shoqëri pluraliste, demokratike.

Paraditen e sotme, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE), në bashkëpunim me Komisionin për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut dhe Kuvendin e Shqipërisë, zhvilloi në Tiranë, seminarin me temë “Qasja në dokumentet historike”, ku mori pjesë edhe kryetarja e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, anëtari, z. Gjergj Marku, si dhe drejtues nga stafi teknik i institucionit.

Në fjalën e hapjes, mbajtur në praninë nënkryetares, znj. Ermonela Felaj dhe deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe ekspertëve të fushës, kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula, tha se: “Përgjatë 25 viteve të tranzicionit të Shqipërisë, nga regjimi totalitar në një shtet demokratik dhe të së drejtës, nevojat për transparencë dhe objektivitet mbi të shkuarën totalitare, kanë qenë po aq të mëdha, sa dhe sfidat e ndërtimit të një shteti demokratik.



Pavarësisht nismave të ndryshme ligjore, të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, mbi amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve politikë, apo për lustracionin e zyrtarëve, hapja e dosjeve të ish-Sigurimit, mbeti një çështje e papërfunduar e shekullit XX.”

Me tej, kryetarja u shpreh, se: “Miratimi i ligjit 45/2015 nga Kuvendi, ishte një gur themeli sa i takon vënies, për herë të parë, në fokus, të së drejtës për informim, mbi dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, hapjes së dosjeve, aksesit të individëve mbi to, si dhe informimit të kërkuesve shkencorë dhe mediave, për hulumtim e për nevoja rishqyrtimi historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit.

Në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën kushtetuese mbi çështjet e lustracionit, jo me më pak rëndësi ishte dhe përfshirja në këtë ligj, e mundësive të verifikimit të figurave për zyrtarë të zgjedhur, apo emëruar, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit të cilësive etike, morale dhe profesionale, në harmoni me pjesën tjetër të legjislacionit në fuqi. “

Sipas znj. Sula, çdo vit, me hyrjen në fuqi të ligjit e në vijim, Kuvendi ka vlerësuar punën e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe ka mundur të konstatojë procesin e vazhdueshëm të informimit dhe transparencës, mbi rreth 47 vjet histori të shtetit të pavarur shqiptar, mbi ngjarje dhe figura historike, mbi aspektet e funksionimit të regjimit, të panjohura më parë, si dhe mbi fate njerëzish.

Për sa i takon ndryshimeve të fundit ligjore, Dr. Gentiana Sula u shpreh, se: “Me miratimin e ndryshimeve në ligjin 45/2022, në fund të vitit 2022, Kuvendi ka krijuar shtratin e nevojshëm ligjor, për t’i dhënë një shtysë më të madhe hapjes, si dhe aksesit mbi dokumentet historike, në mënyrë që çështja e papërfunduar e shekullit XX, të mund të gjejë trajtim të përshtatshëm dhe mbyllje, në aktualin.

“Kështu, duke: i konsideruar dokumentet e fondit të ish-Sigurimit, të deklasifikuara, me përjashtim të rasteve kur mund të cenohet siguria kombëtare, apo marrëdhëniet me shtetet; parashikuar të drejtën e informimit për çdo individ; hequr pengesat në veprimtarinë verifikuese për zyrtarë dhe duke e shtrirë atë edhe mbi zyrtarë të verifikuar nga komisione të mëparshme, është krijuar tashmë baza e nevojshme për garantimin e qasjes mbi dokumentet historike, informimit të publikut, njohjes së historisë, edukimit qytetar dhe vendimmarrjes së informuar,” – përfundoi fjalën e saj, Kryetarja e Autoritetit për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit.

Në harkun kohor 2018-2022, Autoriteti ka deklasifikuar 317 051 fletë dhe me hyrjen në fuqi të ndryshimeve ligjore, ka marrë masa që brenda muajit Mars, të deklasifikojë 610 njësi arkivore ose rreth 13 300 fletë dokumente.



Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE) ka nënvizuar vazhdimisht rëndësinë e transparencës së autoriteteve publike në një shoqëri pluraliste, demokratike, si dhe të drejtën e aksesit publik në dokumentet zyrtare, krahas ekuilibrit midis sigurisë kombëtare dhe aksesit ndaj një informacioni të tillë.

Seminari “Qasja në dokumentet historike” u mbajt në funksion të punës së APKE-së, për përgatitjen e raportit dhe punës së vazhdueshme në Kuvendin e Shqipërisë, për deklasifikimin e dosjeve të sigurisë, të epokës komuniste.

Qëllimi i seminarit ishte mbledhja e parlamentarëve dhe ekspertëve nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, veçanërisht nga vendet me një sundim autoritar në të kaluarën, duke shërbyer si një platformë për shkëmbimin e përvojës dhe praktikave pozitive, në zbulimin e një informacioni të tillë. Për më tepër, seminari do të ofrojë një mundësi, për të diskutuar masat e marra në vendosjen e udhëzimeve të qarta dhe masave mbrojtëse adekuate, në nivele të ndryshme të procedurës së zbulimit të informacionit, për të shmangur abuzimet. Audiencat e synuara përfshijnë deputetë, si dhe përfaqësues të institucioneve përkatëse dhe palëve të interesuara, apo edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

SHQIPËRIA VLERËSOHET SI SHEMBULL PIONIER NË FUSHËN E DEKLASIFIKIMIT TË DOKUMENTEVE HISTORIKE



Tiranë, 04 prill 2023 - Shqipëria mori vlerësime si shembull pionier në fushën e deklasifikimit të dokumenteve historike, nga anëtarët e delegacionit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APPE), të cilët vizituan Autoritetin, menjëherë pas përfundimit të Seminarit, me temë: “Qasja në dokumentet historike”, i mbajtur më datë 31 mars 2023, në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë.

Gjatë vizitës në AIDSSH, Anëtarët e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës panë sallat moderne të arkivit, ekspozitat, teksa në bibliotekën e Autoritetit u njohën me botimet mbi kujtesën historike. Për këtë vizitë, Fynn Heckret u shpreh se, observatori i Këshillit të Evropës për mësimdhënien e historisë në Evropë, ka kënaqësinë të jetë një aleat i të gjitha shteteve anëtare të interesuara në përmirësimin e kornizave për aksesin në dokumentet historike dhe në eksplorimin e mënyrave sipas të cilave, qasja në këto dokumente mund të ndikojë pozitivisht në edukim, sidomos në njohjen e historisë.



TAKIM EKSPERTËSH MBI ELEMENTËT E PUNËS SË DETYRUAR NË MINIERËN E SPAÇIT

Tiranë, 07 prill 2023 - Puna e papaguar në minierat e kundërshtarëve politikë ishte një shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, në komunizëm. Për elementin e punës së detyruar pa pagesë, si formë ndëshkimi për bindjet ose aktivitetet e politike, në të shkruarën, u bisedua me ekspertë financiarë, akademikë dhe inxhinierë të industrisë minerare në vend.

Kjo tryezë, realizuar në kuadër të aktiviteteve të Autoritetit në përkujtim të 50-vjetorit të revoltës në burgun e Spaçit, kryesuar nga kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula dhe anëtari z. Gjergj Marku, kish si qëllim plotësimin e narrativës për Spaçin, si burg dhe kamp pune.



Biseda me profesorët dhe inxhinierët u përqendrua në zbërthimin e kontekstit të punës së bërë nga ish-të burgosurit politikë në minierën e Spaçit. Ekspertët u dhanë përgjigje disa prej pyetjeve që shqetësonin grupin e punës, si p.sh.:

Si kanë shkuar eksportet e industrinë nxjerrëse minerare në vite?

Sa ton bakër e piritit, prodhohej në minierën e Spaçit?

Çmimi i shitjes? Sa ishte numri i të dënuarve me punë të detyruar në Spaç?

Sa ishte pagesa e punës së një minatori në muaj, krahasuar me pagesën e një të dënuari?

Dr. Viktor Doda, ish-ministër i Energjitikës dhe Minierave, vlerësoi faktin se puna për nxjerrjen e bakrit dhe piritit në minierën e Spaçit, bëhej vetëm nga ish-të dënuar politikë që vuanin dënimin në këtë burg. Ai tregoi për kushtet e rënda të punës, si mungesa e veshjeve, masave mbrojtëse, ushqimi i keq,.. që bëheshin edhe më çnjerëzore nisur nga abuzimet e punonjësve të policisë ngarkuar për ruajtjen e tyre.

Dr. Femi Sufaj, nëndrejtor i përgjithshëm i burgjeve bëri vlerësime të hollësishme nga regjistrat e mbajtur në atë kohë, rreth numrit të dënuarve, sasisë së bakrit që prodhoheshin dhe vlerën e pagës që ata merrnin, ku evidentohesh se për realizimin e normës 100 për qind të burgosurit paguheshin vetëm 10 për qind, të pagesës që merrte një minator në kushte të lira pune.

Prof. Dr Kimet Fetau, pedagog në Gjeologji Miniera theksoi se, trauma që kalonin të burgosurit në Spaç, si për nga vështirësia e punës, ashtu edhe ajo e vuajtjes së dënimit ishte e lartë, ndaj duhet të mbështeten nisma për dëmshpërblimin financiar për ta.

Ing. Fran Gjergji, u shpreh se fillimisht, në vitin 1966, kur miniera u hap, nxirrte vetëm 100 mijë ton në vit, ndërkohë një vit më vonë, me punën e të burgosurve politikë ajo u rrit deri në 200 mijë ton në vit, për të shkuar më pas, deri në 1 milionë e 400 mijë ton në vit. Ai dëshmoi se, menjëherë pas vitit 1992, prodhimi dhe eksportit i bakrit ka rënë.

Agron Hoxha, ish- i dënuar në burgun e Spaçit, që ka punuar rreth 13 vite si minator tregoi, për dënimin e padrejtë me punë të detyruar, kushtet dehumanizuese, pagesat qesharake të punës në minierë, si dhe ndëshkimet e rastit, si ridënimi nëse nuk plotësohej norma ose vuajtjet në birucën e izolimit, ku i ftohti në temperaturat -15 gradë, ishte i padurueshëm.



Puna e papaguar në minierat u përdor si një mjet shtypjeje nga regjimi, për t'i mbyllur gojën kundërshtarëve politikë, por faktet tregojnë se përdorej dhe si një mjet për sigurimin e forcave të punës, në sektorët më të vështirë të prodhimit.

Puna e papaguar në minierat, e kundërshtarëve politikë, ishte shkelje e disa të drejtave themelore të njeriut, duke përfshirë të drejtën për liri nga skllavëria dhe puna e detyruar, të drejtën për lirinë e shprehjes dhe organizimit, dhe të drejtën për një gjykim të drejtë. Ajo ishte gjithashtu, një shkelje e standardeve ndërkombëtare të punës, që ndalojnë punën e detyruar dhe kërkojnë që punëtorët të paguhen për punën e tyre.

Autoriteti ruan dhe administron një larmi të madhe dokumentesh arkivore, që përmbajnë dhe



trajtojnë informacione dhe të dhëna rreth të burgosurve politikë që kanë punuar në miniera. Dokumentet, dëshmitë e mbledhura, fotografitë, filmimet na sigurojnë lëndët e parë, jo vetëm për të zgjeruar punën me kujtesës, po edhe për të interpretuar dhe analizuar me qëllim gjetjen e mekanizmave korigjues, për ata që pësuan padrejtësi, duke u përballur edhe me vdekjen në kampet e punës së detyruar, si në Spaç etj.

AUTORITETI DHE INSTITUTI I HISTORISË SË EVROPËS MESHETARE (ISEM-CNR) NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI.

Romë, 11 prill 2023 - U nënshkrua në Romë, marrëveshja mes Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH) dhe Institutit të Historisë së Evropës Meshetare të Kiliarit, Romës dhe Milanos- Këshilli Kombëtar Italian të Hulumtimit, (ISEM -CNR).

Marrëveshja e nënshkruar nga Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula dhe Drejtori i ISEM –CNR, Prof. Gaetano Sabatini, ka si qëllim vendosjen e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike, si dhe për të ndihmuar në njohjen e së shkuarës.

Kryetarja e Autoritetit, Dr. Gentiana Sula tha se, historia është një proces që nuk mund copëzohet gjatë studimit të saj. Periudha e komunizmit, nuk përqendrohej vetëm te regjistrimet, te përndjekja dhe survejimet, por dhe në të gjitha aspektet e tjera të jetës, si ekonomia dhe sektorët e saj, si: nafta, minierat etj.



“Këto dokumente, duhen studiuar që njerëzit të lexojnë historitë e tyre. Kështu, ata do të kuptojnë të shkuarën e tyre, të mendojnë për vetën e tyre, për çështjet që ende sot, janë të pazgjidhura, siç është vënia e drejtësisë në vend, çështja e të zhdukurve që, aktualisht është një çështje shumë e fortë, për shkak se janë mijëra persona që gjenden nën tokë diku, të pagjetur.

Kur vjen puna tek Italia dhe Shqipëria, janë dy vende me një histori të gjatë që i lidh. Përmendim këtu kishën katolike, martirët e saj. Ne kemi raste të personave, intelektualë shqiptarë. që janë arsimuar në Itali, në vitet ‘20 –’30, si Musine Kokalari, në Romë dhe Sabiha Kasimati në Torino, dy intelektuale që u përdoqën, burgosën dhe njëra prej tyre, edhe u pushkatua nga regjimi komunist.

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është të hedhim dritë në historinë bashkohore të Shqipërisë dhe Italisë, nëpërmjet kërkimeve, botimeve dhe projekteve të përbashkëta.”

Drejtori i ISEM–CNR, Prof. Gaetano Sabatini, në fjalën e tij, pasi vlerësoi punën e Autoritetit dhe rëndësinë që kanë burimet arkivore në studimin e shkuarës, tha se: “Marrëveshja e bashkëpunimit, ka në fokus vlerësimin e burimeve arkivore dhe realizimin e aktiviteteve kërkimor- shkencor, lidhur me historinë e të përndjekurve politikë gjatë pushtimit fashist të Shqipërisë ‘39 - ‘43 dhe në vijim, të regjimit komunist ‘44-’91, për rindërtimin e historisë tërësore, të një prej periudhave më të errëta, të historisë së Shqipërisë”.

Objekti i kësaj marrëveshjeje është shkëmbimi i njohurive, informacionit, ekspertizës dhe praktikave më të vlefshme mbi arkivat, duke shkëmbyer po ashtu, të dhëna mbi materiale arkivore dhe dokumente historike, me interes të përbashkët.

Gjatë këtij bashkëpunimi, përparësi do t'i jepet çështjeve që lidhen me:

- ish-qyrtimin dhe riorganizimin e historisë mbi të përndjekurit politikë të diktaturës komuniste (1944-1991);

- rishqyrtimit të figurave historike të akuzuara, apo/dhe survejuarve, si të lidhur me pushtimin fashist të Shqipërisë (1939-1943), duke përfshirë përndjekjen politike në Itali dhe Shqipëri, gjatë diktaturave;
- shkeljes së të drejtave të qytetarëve, duke iu referuar veçanërisht, rindërtimit të paanshëm historik të njëres prej periudhave më të errëta të historisë shqiptare dhe asaj evropiane.



Autoriteti dhe ISEM-CNR, mbështetur në parimet e aksesit të hapur, do të bashkëpunojnë në rindërtimin e arkivave, me të dhëna mbi emigrantët e persekutuar dhe liderët politikë; në projekte shumëpalëshe edhe konferenca ndërkombëtare; në programe të përbashkëta kërkimore për mbrojtjen e arkivave, katalogimin dhe ruajtjen e materialeve dokumentare, si dhe thirrjes së rregullt të tryezave të rrumbullakëta dhe seminareve.

Autoriteti dhe ISEM-CNR ranë dakord, të inkurajojnë bashkëpunimin e zgjeruar mes arkivave, për koleksione kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe sektorët akademikë dhe po ashtu, ndajnë praktikat më të mira me grupet e tyre të interesit, përmes studimeve mbi rastet/ngjarjet, publikimeve, simpoziumeve dhe shpërndarjes së materialeve audiovizuale mbi konferencat/organizimet e përbashkëta.

I pranishëm në këtë marrëveshje, ishte Presidenti i Institutit Kombëtar të Studimeve Romane, z. Gaetano Platania, përfaqësues të ambasadës shqiptare në Romë dhe studiues të historisë.

Një ekip i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), kryesuar prej kryetares Dr. Gentiana Sula, mbajti një seri takimesh të rëndësishme në Romë, në datat 11-14 prill 2023, në kuadër të misionit të tij, për nxitjen e dialogut mbi të shkuarën e vendit nën regjimin komunist, informimit dhe edukimit qytetarë mbi të.

Në qendër ishte nënshkrimi i një Marrëveshjeje Bashkëpunimi me Institutin e Historisë Evropiane Mesdhetare, pjesë e Këshillit Kombëtar Italian të Hulumtimit, me qëllim vendosjen e urave të bashkëpunimit në fushën e kujtesës, për rivlerësimin e personaliteteve dhe ngjarjeve historike. Ekipi mbajti takime me përfaqësuesit diplomatikë të shtetit, Ambasadoren Shqiptare në Romë, znj. Anila Bitri dhe të ngarkuarën me punë pranë Ambasadës së Vatikanit, znj. Majlinda Dodaj, me një komunitet shqiptarësh që jetojnë në Romë, si dhe me studiuesin shqiptar nga Kosova, z. Bejtullah Destani.



Ekipi i Autoritetit përbëhej nga: Dr. Gentiana Sula, Kryetare e Autoritetit; Dr. Albert Nikolla, Anëtar i Autoritetit; Dr. Ornela Arapi, Drejtoreshë e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar; Znj. Mirela Lame, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, Znj. Nevila Turdiu, përgjegjëse e Drejtorisë së Informacionit dhe znj. Migena Demirxhiu, zëdhënëse e Autoritetit.

AUTORITETI TAKIM ME KOMUNITETIN SHQIPTAR NË ITALI: TË PAGJETURIT DHE HISTORITË PERSONALE TË SË SHKUARËS NË FOKUS.

ROMË, 12 prill 2023. Në takimin me përfaqësues të komunitetit shqiptar që jeton në Romë, Autoriteti i njohu ata nga afër, me punën e bërë gjatë këtyre 7 viteve dhe misionin në drejtim të zbardhjes së të shkuarës komuniste dhe edukimit qytetar me të.



Kryetarja znj.Sula, i njohu me marrëveshjen e nënshkruar me Institutin e Historisë Evropiane Mesdhetare, që ka si qëllim rishqyrtimin e historisë mes dy vendeve, nëpërmjet studimit të dokumenteve nga grupe studiuesish, në kuadër të projekteve të përbashkëta.

Mes të pranishmëve, ishte edhe z. Aldo Terruzi, i biri i Giuseppe Terruzit, punonjësit të Bankës Tregtare Italiane në Vlorë, zhdukur në vitin 1947, në burgun e Burrelit, ku vuante dënimin pas akuzave politike të regjimit të sapovendosur në vend.

Prej 30 vjetësh, Aldo Terruzi kërkon eshtrat e të atit, si rreth 200 kërkues të tjerë, të cilët, kanë paraqitur kërkesë pranë Autoritetit, për zbardhjen e fatit të familjarëve të tyre, të pagjetur.



Gjatë takimit, z. Terruzi plotësoi formularin për të zhdukurit dhe u njoh me ndryshimet e reja dhe ligjore, si dhe hapat e ndërmarrë nga Autoriteti, në lidhje me çështjen e të zhdukurve.

Ndër pjesëmarrësit ishte edhe znj. Keti Koçi Currani, një emigrante e fillimviteve të tranzicionit, e cila, vjen nga një familje me histori vuajtjesh, në të kaluarën komuniste të vendit. Ajo u njoh me procedurat e aplikimit për informim, në Autoritet dhe plotësoi formularin përkatës.

Pjesë e takimit ishin: znj. Rovena Sakja, aktiviste në fushën e arkivistikës e interesuar për studime të mëtejshme të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, avokati Saverio Kashuri, interesuar në zbardhjen e së shkuarës, në planin e shkëljes së të drejtave të njeriut në komunizëm, si dhe studiuesja, znj. Alma Hado.



KRYETARJA E AUTORITETIT, DR. GENTIANA SULA TAKOHET ME AMBASADOREN SHQIPTARE, DR. ANILA BITRI LANI

Romë, 14 prill 2023 - Kryetarja e Autoritetit për Informim me Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, Dr. Gentiana Sula, zhvilloi takimin e radhës me Ambasadoren e Shqipërisë, në Itali, Dr. Anila Bitri Lani.

Gjatë këtij takimi u zhvillua një bisedë rreth punës që kryen Autoriteti, në drejtim të zbardhjes së të shkuarës komuniste dhe nevojës së zgjerimit të marrëdhënieve me partnerë evropianë, në fushën e kujtesës historike.



Sula, tha se, “institucioni ynë, tashmë i konsoliduar, është themeluar 7 vite më parë dhe nuk i ka ndalur përpjekjet në drejtim të hedhjes dritë në të shkuarën tonë komuniste. Ne kemi nisur të zbërthejmë të shkuarën, që nga viktima e më gjerë, mbështetur në dokumentet e arkivit, dëshmitë gojore etj. Ndërkohë që po përpiqemi të zgjerojmë bashkëpunimet me Italinë, me nënshkrimin e një marrëveshjeje të gjerë bashkëpunimi dhe ndërveprimi me Institutin i Historisë Evropiane Mesdhetare, pjesë e Këshillit Kombëtar të Kërkimit”.

Sipas saj, kjo marrëveshje synon mundësimin e krijimit të kushteve të kërkimit nga Italia dhe Shqipëria, në drejtim të zbërthimit të ngjarjeve historike që lidhin dy vendet, që nga lufta italo-greke, periudhën e pushtimit fashist në vend dhe më pas, në komunizëm.

Në vijim, Sula, theksoi se bashkëpunimi me studiuesit italianë, do të nisë me një nga projektet më ambicioze të Autoritetit, ajo e muzealizmit të kampit të Tepelenës, një ish-garnizon italian, i ngritur gjatë luftës italo-greke, që u kthye nga regjimi komunist, në një kamp të punës së detyruar për familjet shpallura armike.

Më tej, kryetarja bëri një paraqitje të tipologjisë së arkivës, me dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, mënyra sesi u ngrit kjo arkivë dhe objektivat për ta kthyer Autoritetin, në një institucion kujtese.

Ambasadorja, Dr. Anila Bitri Lani, tha se, “shqiptarët dhe italianët e kanë konsideruar bashkëjetesën, si përqafim kulturash. Nxënësit dhe studentët e sotëm, duhet të njihen me ngjarjet e së shkuarës, ndaj çdo përpjekje në këtë drejtim është e mirëpritur”.



Më tej, Lani shprehu vullnetin dhe mbështetjen për bashkëpunime konkrete me komunitetin shqiptar në Itali, që është i organizuar në drejtimin e ruajtjes së gjuhës shqipe, por dhe është integruar me shumë dinjitet dhe performancë në shoqërinë italiane.

Vizita e Autoritetit për Informim mbi Dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit kishte në fokus rritjen e bashkëpunimit me institucionet e memories, si dhe krijimin e urave lidhëse me komunitetin shqiptar, të emigruar pas viteve 1945 dhe atij të viteve pas rënies së komunizmit, në drejtim të sigurimit të dëshmimeve gojore mbi ngjarje të së shkuarës, rishqyrtimit të historisë, si dhe përcjelljes te të rinjtë.

Sipas statistikave, sot në Itali, jetojnë dhe punojnë rreth 600 mijë shqiptarë, si dhe studiojnë rreth 8 mijë studentë. Një numër i konsiderueshëm emigrantësh vijnë nga familje ish-të përndjekura gjatë regjimit komunist. Ata janë integruar në shoqëritë pritëse. Takimet me ta, Autoriteti i sheh si mundësi për të prezantuar punën e institucionit e po ashtu, për të krijuar dimensione dhe perspektiva të reja në fushën e kujtesës.

TORGUT OZAL COLLEGE ELEMENTARY VIZITË NË AUTORITETIN PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT 1944-1991



20 prill 2023 - Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Sigurimit të Shtetit, Drejtorja e Mbështetjes Shkencore dhe Edukimit Qytetar mirëpriti me shumë kënaqësi, nxënësit e klasave të pesta dhe organizoi për ta, "Ditën e Arkivit të hapur". Nxënësit u njohën me mjediset e Autoritetit, punën e aktivitetet që bëhen me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe prezantimin e trashëgimisë së shkruar - projekt që nisi në gjuhën angleze, - të shkruanim për shkrimtarë të njohur dhe u shtri më gjerë, në gjuhën shqipe.

Kryetarja e Autoritetit Dr. Gentiana Sula, gjithashtu eksperte e njohur për zhvillimin e sistemeve arsimore, si dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fëmijëve, zhvilloi një bisedë të hapur ku nxënësit u përfshinë me kuriozitetin që i karakterizon. Mjaft interesante ishte njohja e tyre me histori reale, të treguara dhe përjetuara në të kaluarën, nga figura të njohura, duke kuptuar rëndësinë e veçantë të ruajtjes së dokumenteve letrare, ligjore, kërkimeve shkencore të kombit tonë. Mbresa të veçanta u la njohja nga afër me arkivën, ku panë dosjet dhe procesin e krijimit të tyre dhe vizita në muzeun e autoritetit, që shpalos më së miri vlerat e trashëgimisë kulturore.

Kjo ditë kaloi me shumë gëzim për fëmijët dhe me momente të paharrueshme.



AUTOTORITETI SË BASHKU ME MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT, ME RASTIN E 50-VJETORIT TË REVOLTËS SË SPAÇIT, SHPALLI NJË KONKURS PËR KRIJIMIN E NJE LOGOJE ME SIMBOLIKË:

“50-VJET NGA REVOLTA E SPAÇIT”



Tiranë, 26 prill 2023 Autoriteti në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit shpalli një konkurs ndërmjet shkollave të mesme artistike, për krijimin e një logoje, me simbolikë: “50-vjet nga Revolta e Spacit”

Pasi u dërguan, punimet e nxënësve u publikuan në vazhdimësi, në rrjetet sociale dhe në bazë të pëlqimeve, më 2 maj u zgjodh fitues punimi i nxënësit Rodjon Zhuri, klasa XII, nxënës i shkollës së mesme artistike “Ajet Xhindole” Berat, me 177 pëlqime.

Autoriteti falënderoi të gjithë pjesëmarrësit në këtë konkurs, duke i vlerësuar për përkushtimin dhe talentin e shprehur në punimet e dërguara, si dhe duke iu uruar suksese në krijime të tjera.

Logoja fituese do të përdoret në komunikimet zyrtare të Autoritetit, për vitin 2023, si dhe materiale të tjera, në përkujtim dhe nderim të kësaj ngjarjeje.





**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT**

Adresa: Njësia administrative nr. 4, Rruga e Dibrës
Garnizoni "Skënderbej", Tiranë
<http://www.autoritetidosjeve.gov.al>